



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.04.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Votimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për programin “UKT shpërndarja e ujit” (*Komision për dhënie mendimi*)

2. Prezantimi i projektligjit “Për vreshtarinë dhe verën” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi , Helidon Bushati, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Tatiana Piro, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Rrahman Rraja, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka, Nusret Avdulla dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Luljeta Bozo, Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj dhe Lefter Gështenja.

Të ftuar:

Frida Krifca – Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Irfan Tarelli - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Alban Mesonjesi - Drejtor Drejtorie në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Julinda Bare - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese Tregtisë dhe Mjedisit.

Të nderuar kolegë, përpara se të fillojmë diskutimin e këtij projektligji kemi lënë një votim pezull nga mbledhja e djeshme “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për programin “UKT shpërndarja e ujit”.

Kush është dakord me këtë projektligj? Kundër? 2 vota. Abstenim? 2 vota.

Atëherë, miratohet në parim.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.04.2022, ora 10:10

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i projektligjit “Për vreshtarinë dhe verën” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi , Helidon Bushati, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Tatiana Piro, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Rrahman Rraja, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka, Nusret Avdulla dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Luljeta Bozo, Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj dhe Lefter Gështenja.

Të ftuar:

Frida Krifca – Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Irfan Tarelli - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Alban Mesonjesi - Drejtor Drejtorie në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Julinda Bare - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Arben Pëllumbi – Sot në rendin e ditës kemi prezantimin e projektligjit “Për vreshtarinë dhe verën”. Relator është zoti Fadil Nasufi. Për të paraqitur projektligjin kemi prezent ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zonjën Frida Krifca, kemi drejtorin e Përgjithshëm Irfan Tarelli, kemi zotin Alban Mesonjësi, drejtor gjithashtu, që tani është bërë i përhershëm në komisionin tonë dhe zonjën Julinda Bare, përgjegjëse sektori. Mirë se rdhët!

Fillojmë shqyrtimin e projektligjit “Për vreshtarinë dhe verën”, zonja ministre fjala për ju.

Frida Krifca – Mirëmëngjesi edhe një herë!

I nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të komisionit,

Faleminderit për mundësinë, për të prezantuar para jush një projektligj shumë të rëndësishëm, pjesë e akteve ligjore që përafrojnë legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit European.

Më lejoni ta nis duke ju dhënë një panoramë të këtij sektori, aktualisht në Shqipëri, vreshtaria dhe verëtaria zënë një peshë të rëndësishme në të ardhurat dhe punësimin në zonat rurale, plus është edhe traditë e popullatës sonë. Statistikat tregojnë se në matjen e fundit të vitit 2021, ne kemi 12 100 hektarë vreshta dhe gati 26 000 hektolitra verë të prodhuar, trend që ka ardhur duke u rritur në 10 vjetët e fundit. Së fundi, ka filluar edhe kultivimi i rrushit të tavolinës në serra, të cilin po e mbështesim edhe në skemat kombëtare këtë vit, pasi ky produkt siguron hershmëri të prodhimit dhe rendiment të lartë.

Pavarësisht se nuk është objekt i këtij ligji, dua t’ju bëj një ekspozë, për të dhënë pak dije mbi sektorin. Aktualisht, në Shqipëri kemi mbi 60 kantina vere, të cilat janë të shtrira në të gjithë territorin, subjekte që prodhojnë verë të cilësive të ndryshme, deri në standardin më të lartë. Shifrat referuar eksportit janë në rritje, por nuk janë aty ku duam ne, ndaj dhe po propozojmë sot para jush këtë ligj. Kemi diku te 12,5 milionë lekë shitje për vitin 2020 në eksport dhe një rritje prej 28% në vitin 2021 me eksport vere në vlerën 16 milionë lekë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e ka mbështetur këtë sektor me financime nga buxheti i shtetit nëpërmjet skemës kombëtare, për të rritur sipërfaqen e mbjellë me vreshta, ku vreshtat me kultivarë autoktonë janë të një rëndësie të veçantë. Ne, gjithashtu, kemi mbështetur përpunimin e rrushit me linja përpunimi, me anë të fondeve europiane IPARD, duke i mbuluar deri në 60% kostot e këtyre sipërmarrësve.

Gjithashtu, kemi krijuar kadastrën e vreshtave me anë të qendrës së transferimit të teknologjive në Fushë Krujë, ku pothuajse kanë përfunduar regjistrimet e të gjitha sipërfaqeve me mbi 1 mijë metra katrorë me vreshta dhe deri tani kemi të regjistruar rreth 7300 hektarë.

Nga regjistrimi që kemi kryer ka rezultuar se kultivarët autoktonë më të rëndësishëm janë: Kallmeti, Sheshi i zi, Sheshi i bardhë, Vlosh dhe të tjerë. Ndërsa kultivarët e importuar kryesisht janë: Merlot, Kabernet Sauvignon, Shardone, Riesling, Petit Verdot, Shiraz, Vranac e të tjera. Më falni për shqiptimin e emrave të tyre.

Pikërisht, për të përmirësuar dhe rregulluar këtë kulturë bujqësore dhe këtë treg, kemi hartuar këtë ligj të ri për vreshtarinë dhe verën, i cili është hartuar në kuadër të procesit për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Europian. Rregullat do të jenë më të forta, por edhe produkti që do të tregtohet dhe do të prodhohet, do të ketë cilësi më të lartë, si dhe më shumë mundësi eksporti dhe me vlerë më të lartë tregtare. Ligji i ri ka për qëllim kryesor krijimin e bazës ligjore për kultivimin e vreshtave për prodhim vere, regjistrin e vreshtarisë, prodhimin, etiketimin, marketingun, prodhimin potencial dhe kontrollin e produkteve të verës në vendin tonë, sipas kërkesave dhe standardeve të tregut ndërkombëtar, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, ruajtjen e një konkurrencë të drejtë ndërmjet prodhuesve të verës dhe operatorëve të tjerë në këtë sektor, promovimin e produkteve të verës përmes politikave të cilësisë, përcaktimin e qartë të rregullave për eksport, si dhe kushtet që duhet të plotësojnë verërat e importuara.

Kantinat dhe vreshtat janë automatikisht të përfshira në prioritetet e Ministrisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural pasi përbëjnë një potencial të fortë eksporti, siç e përmenda edhe më parë. Duke qenë se janë një objekt i fortë i sigurisë ushqimore në vend, ato përmbajnë një fuqi madhore nëse përkthehen në produkte të turizmit rural, si dhe ofrojnë një mundësi shumë të madhe për inovacion, për dixhitalizim për start-up-e dhe për investime të reja në sektor. Jemi të bindur se prodhimi i verës do të kontribuojë njëkohësisht në rritjen e të ardhurave personale të angazhuara në rritjen ekonomike në Shqipëri, si dhe në standarde më të larta për mbrojtjen mjedisore. Integrimi i prodhimit të qëndrueshëm të rrushit dhe verës dhe lidhja me turizmin rural, janë hapat e para në këtë rrugëtim plot me sfida.

Në fund të fjalës sime më lejoni të kujtoj edhe partneritetin e ngushtë që ne kemi si Ministri e Bujqësisë me Universitetin Bujqësor të Tiranës, për të cilin jam e bindur se do të rezultojë në ofrimin e programeve të dedikuara orientuese për të rinjtë drejt profileve të

vreshtarisë, enologjisë apo turizmit të verës. Ligji është punuar në bashkëpunim me FAO-n, nga një konsulent i FAO-s në fakt. Ne e kemi kaluar në qeveri që në dhjetor të vitit 2020. Ka kaluar shumë kohë, në fakt, për hir të së vërtetës dhe kemi një lloj dëshire për ta çuar përpara këtë proces, sepse realisht mendojmë që ligji sjell risi, sjell formalizim, sjell rregullim në treg, i cili aktualisht mungon dhe do të forcojë objektivin që kemi drejt eksporteve.

Natyrisht, gjykojmë që duhet t'i nënshtrohet një konsultimi publik, ndërkohë që është në Kuvend për ta rinovuar atë, pavarësisht se ky është kryer në kohë.

Kaq kisha për të thënë.

Jam e hapur për pyetje.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjala për relatorin, zotin Nasufi.

Fadil Nasufi - Faleminderit, zonja Ministre për të gjithë panoramën e paraqitur, edhe për situatën në sektorin e vreshtarisë dhe të verërave, por edhe për draftin e këtij projektligji, i cili, në këndvështrimin tim, me shumë kapilarë, ka terma, procedura dhe teknikalitete shumë të hollësishme dhe reflekton mbi ligjin e vjetër, që është i vitit 1991, dhe ka aq shumë elemente, sa i ngjan një procedure lindjeje fëmije, që do një përkujdesje që nga momenti që lind e gjithë jetën. Kjo ka të bëjë edhe me atë pakt që produktet e rrushit dhe të verës janë aq të pranishme në tryezat tona dhe janë aq të lidhura. Në një poezi Xhevahir Spahiu thotë:

“Një gotë tha i pari,
i dyti tha ma mbush me gjak vetime
dhe Zoti tha:
prisni të mbush edhe unë kupën time”.

Kështu që është aq delikat dhe aq i domosdoshëm që ne ta fusim në rrugën e industrializimit, siç e kanë vendet më të zhvilluara, që i kanë produktet e verërave në majat më të larta të cilësisë dhe të konkurrencës.

Kam parë të gjithë dokumentacionin. Ju u jeni referuar modeleve të Greqisë, të Italisë, të Francës, të Spanjës, të Portugalisë, të Mbretërisë së Bashkuar, ku janë parashikuar edhe institucionet përgjegjëse për kontrollimin e prodhimit dhe të licencimit apo të regjistrimit të vreshtarisë. Kështu që ky ligj ka shumë qasje me vendet më të zhvilluara dhe është në këto standarde që i përgjigjet edhe direktivës europiane për këtë qëllim.

Siç e thatë edhe ju, ky projektligj vendos rregulla të qarta për kultivimin e vreshtave, që përdoren për prodhimin e verës, për regjistrimin e vreshtarisë dhe për prodhimin, etiketimin, marketingun dhe kontrollin e produkteve të verës në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, ky ligj synon mbrojtjen e interesave të konsumatorëve duke ruajtur një konkurrencë të drejtë ndërmjet prodhuesve dhe importuesve në sektorin e verës, nxit përmirësimin e cilësisë së produkteve, duke mundësuar masa kombëtare për politikën e cilësisë në sektorin e verës.

Fusha e veprimit të këtij ligji prek si personat juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, që zhvillojnë aktivitete ekonomike që lidhen me qëllim e këtij projektligji. Pa dyshim, ky projektligj vjen i konsultuar nga grupet e interesit. Edhe unë, duke e marrë sinjalin shumë shpejt, me ardhjen e këtij projektligji në tavolinën e komisionit, kam bërë konsulta me disa kantina në rajonin e Beratit, ma kantinat Nurellari, Çobo, Malinati, Luani etj. Fatmirësisht, edhe këtu në komision kemi të nderuarin deputet, kolegun Ramadan Lika, që do të jetë shumë më konkret në prononcimet, kur të jenë fazat e tjera, gjithashtu, edhe deputetin Agron Duka. Kështu që në termat teknikë dhe profesionalë unë e rezervoj veten, por flasim siç e ka standardi i prezantimit të një projektligji që, për mendimin tim, ashtu siç e thatë edhe ju, ka disa objektiva:

Së pari, organizimin e sektorit të vreshtarisë dhe të verërave.

Së dyti, rritjen dhe përmirësimin e konkurrencës ndaj verërave të importuara.

Së treti, rritjen e eksporteve, garantimin e interesave të konsumatorit dhe të prodhuesve, nëpërmjet sigurimit të një sistemi gjurmueshmërie nga ferma në tavolinë.

Së katërti, ruajtjen e autenticitetit, karakterit tradicional të produktit dhe mbrojtjen e rajoneve sensitive të kultivimit të hardhisë.

Gjithashtu, synojmë të rritet edhe identiteti i produktit “*Made in Albania*”.

Siç e tha edhe ministrja, nevoja e hartimit të ligjit vjen, sepse ky sektor është zhvilluar shumë gjatë kësaj periudhe dhe miratimi i një sërë direktivash europiane bëjnë ta përafrojnë këtë ligj me kushtet që dikton koha për këtë rregullim të ri që nis nga çështjet e termave dhe deri tek elemente të tjera që kanë të bëjnë me këtë sektor të rëndësishëm.

Gjithashtu, edhe nevoja e harmonizimit të legjislacionit në këtë sektor me legjislacionin për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës dhe termat tradicionalë me legjislacionin për pronësinë industriale, me legjislacionin për akcizat, për lejet e mjedisit, legjislacionin për skemat e cilësisë së produkteve është një tjetër arsye për ta sjellë në parlament këtë projektligj.

Risitë u thanë, por unë do të bëja pyetje për panoramën e tanishme, por ministrja iu përgjigj duke na dhënë rezultatet e deritanishme.

Për të kaluar tek efektet e buxhetit, ku janë parashikuar 2 milionë e 300 mijë lekë shpenzime për komisionin e verës, por e nuk e shoh këtë të parashikuar për Këshillin Kombëtar të Verës. Besoj se do të hajë diskutim kur të fillojmë ta trajtojmë ligjin nen për nen.

Ligji është hartuar nga Këshilli i Ministrave, është bërë konsultimi publik, por dua të di nëse janë reflektuar në këtë draft apo jo ndërhyrjet apo propozimet që kanë bërë grupet e interesit.

Në projektligj përmendet Kadastra e Verës, por nuk ka një përkufizim në nenin e përkufizimeve, në kuptimin që rrjedh nga leximi i nenit 11; rezulton se Kadastra e Vreshtave do të jetë një pjesë e të dhënave që përmban regjistri i vreshtarisë, ndërkohë që, sipas përkufizimit të ligjit ekzistues, Kadastra e Vreshtarisë dhe e Verës është regjistri me të dhënat që shërbejnë për njohjen e saktë dhe në çdo kohë të kohë të gjendjes së vreshtarisë dhe të kantinave të përpunimit të rrushit. Pra, duket sikur ka një paqartësi dhe një mbivendosje në përdorimin e termave “regjistër” dhe “kadastër”. Pra, mund të rishikohet.

Siç e thashë, në pikën e efekteve financiare duhet të shihen të gjitha institucionet që merren me kontrollin, që merren me këshillin kombëtar, që janë të përcaktuara kryesisht te neni 8 i projektligjit, si dhe për shpërblimin e anëtarëve që bëjnë pjesë në komisionin e vinikulturës.

Ligji e sqaron që produkti i verës, që është në gjendje tani, para se të futet në veprim ky ligj, u jep kohë gati dy vjet prodhuesve të verës të heqin nga tregu të gjitha produktet që kanë, me qëllim që t’i përshtaten projektligjit të ri.

Kaq kisha për sa i takon këtij projektligji.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Të nderuar kolegë,

Hapim seancën e pyetjeve dhe të diskutimeve.

Kush e dëshiron fjalën?

Urdhëroni, zoti Duka!

Agron Duka – Ne jemi një vend mesdhetar. Unë po them dy fjalë, se duhet të bëhet një hyrje. Vreshtat dhe verërat kanë një traditë shumë të lashtë në Shqipëri. Ne njihemi nëpërmjet këtyre zbulimeve arkeologjike, dokumenteve, qysh në epokën para Krishtit kemi konsumuar

verën. Më vonë, në Luftën e Dytë Botërore, në kohën e Zogut, kemi pasur rreth 2700 hektarë vreshta. Pastaj ra filoksera dhe në vitet '80 (nuk e them dot këtë, sepse dua ta krahasoj me sot) ne arritëm në 20 mijë hektarë, pra kulmin. Pas viteve '90 shkuam te 5 mijë hektarë, ndërsa sot kemi 12 mijë hektarë, thotë ministrja, nuk po e kontestoj. Pra, jemi më pak se vitet '80, që do të thotë se traditën e kemi, vend mesjetar jemi, kemi një klimë të mrekullueshme, kemi tokë të mrekullueshme, por nuk jemi aty ku duhet. Pra, një ndër këto që do të ndikojë, është edhe ligji që po kalojmë sot.

Duhet thënë disa fjalë të mira për sa u përket donacioneve që u janë dhënë kantinave ndër vite, po sidomos vitet e fundi, shumë kantina kanë marrë donacione, të cilat i kanë ndihmuar për të bërë verë të cilësisë së lartë, subvencione. Shqetësimi është që kemi disa probleme me ligjin. E para për mbrojtjen e varieteteve autoktone, siç e tha edhe ministrja, që nuk janë të qarta në ligj, janë të shkruara në nenet 15, 19, 20, kapitulli IV.

Për sa u përket treguesve gjeografikë dhe emërimit të mbrojtur të origjinës, do të them vetëm disa gjëra, që janë pikante; i kemi hasur realisht edhe në praktikë; nuk po kaloj shumë në teori.

Një problem tjetër: ne kemi verë cilësore sot, prodhimi në Shqipëri ka arritur mbi 100 kuintalë për hektarë; bëhet spërkatja me karenxhë të ulët, jo si përpara viteve '90 që ishte karenxhë e gjatë dhe ishin të dëmshme për organizmin. Tani shohim në supermarketet tona, në tregun tonë verëra 2,8 euro që vijnë nga Italia. Si ka mundësi? Sepse nuk kontrollohen. Kjo duhet të sanksionohet në ligj. Duhet që jo çdo njeri i pajisur me NIPT të importojë verë. Duhet që ata, të cilët importojnë verë, të jenë njerëz të përcaktuar, të cilët merren me importin e verërave, në mënyrë që shteti të dijë dhe t'i kontrollojë, të bëjë analizat e atyre verërave që hyjnë në Shqipëri. Është e pamundur. Si ka mundësi? Ai vjen me 2,8 euro këtu me gjithë transportin. Këta që prodhojnë verërat, i del kostoja më e lartë se sa aq. Është një thënie e një ustai të një kuzhine në Itali, ka vdekur, nuk e di si e kishte emrin, Montaneli më duket që thoshte: "Vera më e mirë është ajo që pihet në fshat". Pse e thoshte këtë? Sepse aty ku bëhet sidoqoftë ajo është verë e mirë. Ne kemi verë autoktone. Ne kemi klimë të shkëlqyeshme, krasitje e shkurtër, prodhim jo shumë i madh, jo me 200 e ca kuintalë, siç e bëjnë italianët, me 70, 80, me teknologji të huazuar nga Italia, nga Franca me të gjitha pajisjet. Kur vjen puna, kalon mbijetesë për ta shitur 7-8 mijë lekë. Ndoshta e teproj pak me këto shifra, ndërkohë që na vjen nga importi. Hyjnë verëra shumë false, realisht. Një Brunelo originale me Brunelon, që shitet në Shqipëri, ka

ndryshim jashtëzakonisht të madh. Ka vetëm etiketën Brunelo, por nuk ka gjë brenda dhe na konkurrojnë. Prandaj duhet patjetër që ta kanalizoni këtë punë dhe të kontrolloni verërat që hyjnë, t'u bëhen analizat. Nëse merret, për shembull, Ismeti vetëm me verën, është shumë më kollaj, që autoriteti që merret më atë punë, të marrë mostrat dhe të bëjë analizat. Jo çdo njeri, që ka NIPT, thotë: "Po, marr ca ilaçe, po marr edhe këtë e po fus disa shishe verë". Të kontrollohet ai. A duhet të bëjmë një gjë që të mbrojmë prodhimin e verës? Masa proteksioniste nuk të le njeri, por ato, që të lejon ligji shqiptar, duhet t'i bësh.

Kam diçka tjetër: ju duhet të keni një institucion që merret me verën. Ka ekzistuar për një kohë (zoti Tarelli ka qenë atje më duket) një institucion që merret vetëm me verën, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, por jo një departament që keni ju atje, që merret me bimët, ndërmjet të tjerave, futet edhe vera. A doni ta bëni sektor prioritar këtë? Duhet patjetër të bëhet kjo punë. Të ketë një departament që merret vetëm me verërat ose të ketë varësi dyfishe, do të ishte më mirë, si AKU-ja që është nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë, por edhe nga Kryeministri, nëse doni t'i jepni prioritet, sepse vendi ynë është me traditë, me klimën e të gjitha me radhë që mund ta bëjë këtë punë, por duhet ta mbrojmë, se, po nuk e mbrojtëm, nuk e bëjmë dot, përveç asaj pjesës subvencionuese që e keni bërë. Kjo periudha e fundit ndoshta ka qenë më e mira e mundshme që është bërë nëpër kantinat e verës.

Di një rast që realisht ka ndodhur, një turist çek bleu në Shqipëri 6 mijë shishe verë, shkon vera deri në Çeki, ka ndenjur 1 muaj në Çeki se nuk zhdoganohej, për arsye se nuk kishte autoritet të njohur nga çekët. Ndërkohë që e bëni me AKU-në, AKU-ja nuk është e certifikuar. Nuk e di sesi u zgjidh ajo gjë me shumë probleme. Pas një muaji u zhdoganua ajo sasi vere. Ky institucion, nëse ju do të lini AKU-në për këtë certifikatën VI -1, duhet patjetër të certifikohet dhe të njihet nga të tjerët, sepse ne jemi drejt eksportit. Këtu ka verëra shumë të mira. Zotëria atje përmendi disa apo atje ku do të shkojmë në Veri, që është traditë që u rezistoi dhe otomanëve faktikisht. Pasi u shkatërruan verërat në Shqipëri nga pushtimi otoman, vetëm në Veri ka pasur verë; edhe Kallmeti ka mbijetuar gjithë kohës. Kemi verëra cilësore që edhe ne mund të na shënojnë që t'i çojmë, por na jepni pak mundësi që t'i çojmë. Këto gjërat burokratike ju duhet t'i hiqni. Sot, për shembull, mos ju duket çudi që ne mund ta eksportojmë verën. Ka vende që bëjnë verëra shumë të mira, por gjithsesi për të pasur një produkt shqiptar ata e kërkojnë, jo vetëm kjo, por ka komunitet shqiptar që jeton nëpër vende të ndryshme të botës deri në Amerikë që kërkojnë produktet shqiptare. Të paktën anët burokratike duhet t'i lehtësojmë.

Pak a shumë, kaq kisha.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duka!

Ta bëjmë pyetje-përgjigje, meqenëse është një projektligj që do ta kemi gjatë nëpër duar. Prandaj do të kemi mundësi që të gjithë të diskutojmë dhe të shprehim shqetësimet tona. Fjala për ju, zonja Ministre.

Frida Krifca – Po i përgjigjem zotit Duka, sepse ai vjen me njohuri ndoshta dhe më shumë sesa ne për sektorin, prandaj do të duhet që të kuptohemi.

Projektligji që sjellim, rregullon pikërisht kërkesën për të importuar në vendin tonë produkte nga subjekte të licencuara. Ligji aktual nuk kërkon subjektet e licencuara, prandaj ne u fusim detyrimin importuesve të jenë të licencuar enkas nga autoritetet sipas ligjit: QKL-ja dhe nga Ministria e Bujqësisë me licencë. Pra, e rregullojmë këtë aspekt.

Aktualisht eksportin për verën shqiptare e kemi të hapur në të gjitha vendet e botës, nuk kemi kufizime. Madje, statistikat tregojnë se ne eksportojmë rreth 15% të produktit tonë në Gjermani, në Mal të Zi rreth 13,5 %, në Kosovë rreth 43% të tjerat janë më të vogla. Nuk kemi kufizime për importin. Çështjet e eksportuesve, të cilët bllokohen rrugës, janë çështje të palës importuese nga krahu tjetër. Produkti shoqërohet me një certifikatë eksporti kur del nga Shqipëria.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta verifikoj rastin, por, për sa kohë ne eksportojmë në Gjermani, nuk ka asnjë arsye pse ne të mos na njohin çekët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, por po them në parim. Nëse na njohin gjermanët, nuk ka sesi të mos na njohin çekët.

Të kuptoj shumë qartë dhe do ta verifikojmë, por në parim, në aspektin e bazës rregullative nuk ka sesi.

Ju informoj se aktualisht jemi në një proces ristrukturimi të ministrisë, është një punë shumë voluminoze që po bëjmë. Kam vërejtur që ministria aktualisht ka një strukturë që nuk përshtatet me orientimin që dua t'i jap ministrisë për të qenë në linjë me kapitujt e BE-së dhe me procesin integruar që e kemi prioritet shumë të rëndësishëm. E gjithë struktura do të vijë në raport me kapitujt dhe ne do të kemi një sektor që do t'i përgjigjet nevojës që ju përmendët, me

njerëz të dedikuar të përgjegjshëm për sektorin e verës. Do të jemi sipas kapitujve 10, 11 dhe 12, por do të kemi rast ta përmendim këtë herë tjetër.

Arben Pëllumbi – Zonja Ministre, meqenëse jemi këtu, para se të vazhdojnë kolegët, sepse shqetësimi që ngriti zoti Duka është i drejtë. Ne për hir të MSA-së kemi disa kuota importi dhe eksporti, në mos gaboj, janë rreth 60 mijë hektolitra që ne lejohe mi të importojmë. Ne vërtet i kemi rritur kuotat, por që të sjellin verë të mirë jo verën 2 euro, për verë që ka thjesht ngjyrë, ka këtu lëndë sa të duash. Ky është besoj një nga shqetësimet që ngriti zoti Duka. Ne të importojmë pa diskutim, se importon e gjithë bota verë cilësore, verë me emër, por verë, e cila është një konkurrent i drejtpërdrejtë i prodhimit vendas dhe i pandershëm, kësaj unë nuk e di, se ne nuk mund të bëjmë kufizime të natyrës protektive, por duhet të gjejmë një mekanizëm, që të paktën kjo verë, që s'është as verë, së pari të mos plotësojë këto 60 mijë hektolitrat, për të cilat kanë nevojë importuesit, për të sjellë verërat cilësore që i nevojiten tregut, dhe e dyta të mos i bëjë konkurrencë të pandershme produktit vendës. Sepse, sido që të jetë, me të jemi rritur, edhe me produkte cilësore, ndaj besoj se pjesën më të madhe të produktit lokal e kemi akoma si bazë, atë verën e tavolinës. Ky produkt që na vjen nga jashtë, me këto çmime të lira, është konkurrues i drejtpërdrejtë i prodhimeve tona. Proteksionizëm s'bëjmë dot, por ndoshta mund ta gjejmë një mekanizëm se si ta bëjmë këtë gjë.

Frida Krifca – Kryetar, shqetësimi është shumë i drejtë. Aktualisht, për importin e verës, ne kërkojmë që të jetë i shoqëruar me fletë-analizë. Pra, nëse fletë-analiza nuk respekton standardet e përcaktuara nga autoritetet e sigurisë ushqimore, nuk lejohet. Nëse ka import pa doganë, nuk të them dot se çfarë është, sepse nuk është objekt i punës sonë. Sigurisht, ne na nevojitet të mbrojmë prodhimin vendës, sepse tashmë jemi bashkëfinancues në atë prodhim. Kemi gjithë dëshirën e mirë të rrisim kapacitetet. Siç e tha dhe zoti Duka, është një produkt që ne dimë ta bëjmë mirë, na vjen e natyrshme ta bëjmë mirë. Aktualisht, kemi një përmirësim të cilësisë me një hov të jashtëzakonshëm. Kemi verëra shqiptare, që mund të konkurrojnë denjësisht me markat më të mira. Nëse i shikoni në një menu restoranti, po të mos jenë etiketat nuk do ta bënit dot diferencën. Kësisoj, nuk ka asnjë arsye që ne të mos përqendrojmë forcat për të mbështetur prodhimin vendës, por njëkohësisht jemi të detyruar të respektojmë edhe marrëveshjet e tregtisë së lirë, marrëveshjet e një tregu të hapur. Ajo që mund të bëjmë dhe ajo që po bëjmë nëpërmjet këtij ligji, është të përforcojmë rregullat e marketimit, të fusim indikatorët e treguesve gjeografikë, ato të origjinës, marketimin, dhe ta përputhim atë me ligjin e cilësisë, në

mënyrë që të rrisim standardin e prodhimit të brendshëm, që rrjedhimisht ta bëjmë edhe më konkurrues në tregjet ndërkombëtare, por edhe këtu.

Na duhet të bëjmë shumë punë me edukimin e konsumatorit e të tregtarëve, në fakt, që në restorante apo në pika shitjeje të kenë gjithmonë një ofertë për të pasur një produkt vendor.

Arben Pëllumbi – Falemnderit!

Zoti Mziu. Zoti Duraj pastaj. Zoti Beqiraj.

Xhelal Mziu – Falemnderit!

Në fakt, sektori i vreshtarisë dhe i verërave është një sektor shumë i rëndësishëm, por pavarësisht potencialeve që ne kemi, nuk ka atë fuqinë e nevojshme, qoftë prodhimi i rrushit, qoftë verërat. E them këtë, sepse shoh se jo pak persona që unë njoh, shkojnë dhe marrin makina me rrush në Maqedoni, për të prodhuar raki apo verë.

Së dyti, pavarësisht potencialeve që ne kemi, po prapë shoh se qoftë Mali i Zi me verën e tij Vranac, qoftë vera e Suharekës në Kosovë apo në Maqedoni, ndonëse janë vende që nuk kanë potencialin e Shqipërisë prodhojnë verëra, të cilat gjejnë vend në Shqipëri. Në fakt, në Shqipëri nuk është ajo konkurrencë, nuk është ai volum, dhe besoj se shkaku kryesor i kësaj është qeveria. Pra, kjo do të thotë që më së pari, qeveria duhet të ketë vëmendje të veçantë në mbështetjen e prodhimit, por së dyti edhe kantinat e verës, për t'i bërë ato konkurruese.

Po të vëmë re, gjatë këtyre dy-tre viteve të fundit është rritur shumë prodhimi i vajit të ullirit, gjë që ka ardhur si rrjedhojë e një politike, që u zhvillua para pesëmbëdhjetë vjetësh apo para dhjetë vjetësh në stimulimin e mbjelljes së ullirit. A nuk do të duhej të ishte prioritare, për ta kthyer në një periudhë pesëvjeçare mbështetjen maksimale ndaj këtij sektori, por edhe duke e ndihmuar.

Nuk besoj se dikush tjetër ka më shumë mundësi se sa ministrja e Bujqësisë apo Ministria e Bujqësisë, që me aktorët e saj t'i vijë në ndihmë, së pari për të pasur një hartë se cilat janë tokat që duhet të kultivojnë vreshtin, sepse ka Universitetin Bujqësor, ka institucionet e tjera kërkimore-shkencore. Nga ana tjetër, edhe për t'i stimuluar, për t'i ardhur në ndihmë këtyre fermerëve, në lidhje me përcaktimin e zonave që e prodhojnë verën.

Së dyti, për të stimuluar prodhimin vendës. Ne kemi Sheshin e Bardhë, kemi Sheshin e Zi, kemi Merlot, por edhe plot varietete të tjera, që i dinë më mirë kolegët e mi, të cilët merren me këtë punë. Pra, për t'i stimuluar më shumë se varietetet e tjera, që ta ndërmarrin këtë aksion.

Sipas këndvështrimit tim, duhet të ketë një angazhim maksimal për t'i stimuluar, mbështetur, orientuar ndaj mbjelljes së vreshtarisë, me synimin e të shkuarit te standardi i këtyre verërave, që verërat tona të jenë konkurruese jo vetëm në Shqipëri, por së paku edhe me verërat e tjera të rajonit. Ne kemi luksin e të pasurit komshi Italinë, e cila është rekord në botë në lidhje me prodhimin e verërave, për të ndërmarrë informacionet që ato kanë.

Mbaj mend një rast, kur ishim në Itali si shoqatë bashkive. Ishim te Gaia, dhe në një kodrinë prodhoheshin katër lloje verërash, të cilat kishin çmime dhe cilësi të ndryshme. Pra, imagjinoni çfarë mund të ndodhë, nëse ju do të bënit një orientim nëpërmjet këtyre strukturave apo nëpërmjet subvencioneve që u jepni këtyre aktorëve. Kjo pa lënë mënjanë Universitetin Bujqësor, i cili është me të vërtetë hallkë shumë e rëndësishme jo vetëm në komisionime, por edhe në orientimin e tregut.

Një gjë tjetër që më bëri përshtypje janë sanksionet, të cilat në këtë moment më duken pak si të rënda për biznesin, por që mendoj se mund të rishikohen, që të mos jenë frenuese sa i takon stimulimit të prodhimit dhe shkuarjes drejt standardeve. Nga ana tjetër, thuhet se përdorimi i këtyre të ardhurave që krijohen nga sanksionet shkojnë te buxheti i shtetit. A nuk do të ishte normale që këto sanksione të shkonin, le të themi, për stimulimin e mbjelljeve të reja. Po marr vetëm një rast: 486 gjoba kishte vendosur bashkia e Tiranës vitin që shkoi. Imagjinoni sikur ato para të përdreshin për sinjalistikën apo për parkimet e reja, se çfarë ndihme do të ishte për qytetarët. E njëjta gjë do të duhej të ndodhte edhe me penalitetet që jepen për këtë sektor, që të shkonin për mbjellje të reja apo për stimulimin e kantinave të verës.

Unë këto probleme kisha, pasi besoj se edhe kolegët e tjerë kanë çështje të specifikave të veçanta, nga çfarë ata kanë konstatuar.

Arben Pëllumbi – Falemnderit, zoti Mziu!

Zoti Duraj!

Laert Duraj – Falemnderit!

Besoj se të gjithë, siç e përmendi edhe ministrja, sa herë që na është dhënë mundësia të jemi me miqtë tanë të huaj, si dhe italianë ashtu edhe francezë, që janë ekspertë të verërave, e kemi ndjerë se si ka evoluar sjellja e tyre në tavolinë kur ne u kemi ofruar verë shqiptare. Vitet e para e prisnin me një lloj buzëqeshjeje që shkonte deri në keqardhje, ndërkohë që sot keqardhja ia ka lënë vendin admirimit. E me të vërtetë, unë kam parë se janë ndjerë shumë të surprizuar nga

cilësia e verërave tona. Kësisoj, respekt për ata që prodhojnë verëra dhe merren me vreshtari, si dhe dy kolegëve këtu në komision.

Të them të drejtën, në lidhje me këtë sektor unë e vlerësoj shumë punën e ministrisë dhe vërej se edhe për kolegët e opozitës është e njëjta gjë. Pra, është një lloj fryme shumë pozitive ndaj këtij projektligji, i cili është për t'u vlerësuar shumë. Gjithashtu, vlerësoj edhe qasjen që ka ministria ndaj Universitetit Bujqësor, sikundër e përmendi edhe kolegu, pasi është vërtetë një lloj qasjeje dhe bashkëpunimi, i cili duhet të jetë standard jo vetëm për Ministrinë e Bujqësisë, por dhe për të gjitha ministrinë e tjera, ku ekspertiza e profesorëve, e akademikëve, e universiteteve, duhet të jetë patjetër diçka e pranishme. Në këtë rast, ky ligj bën që marka *Made in Albania*, edhe për verën, të jetë cilësore dhe të krijojë ca standarde ndërkombëtare.

Do të kisha vetëm një kërkesë ose një lloj sugjerimi, se si të bëhet e mundur që vera cilësore, që do të bëhet edhe më cilësore pas këtij projektligji, siç e përmendi edhe ministrja, të jetë sa më pranë konsumatorëve ndërkombëtarë, në këtë rast. Vërtet mund të kemi sasi të limituar eksportesh, për shkak të kontratave që kemi me BE-në. Por ka edhe vende të tjera jashtë BE-së, që janë klientët tanë, për sa i përket fushës së turizmit.

Pra, çfarë incentivash mund të kishin karantinat e verës? Me shumë keqardhje kam konstatuar që shumica e hoteleve tona të mira në bregdet nuk kanë verëra shqiptare dhe mua më vjen vërtetë shumë keq te kjo pjesë.

Pra, si mundet të gjenim një mënyrë, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Turizmit, me ndonjë agjenci të caktuar apo me shoqata që jo t'i detyronim, se fjala "detyrim" është pak e tepërt, por të kishin incentiva për hotelet kryesore? Ose të vinit një kusht, që, nëse do të kesh tre yje e lart, patjetër duhet të kesh një prodhim shqiptar, jo vetëm verë, se në këtë rast ne po flasim për verën, por mund të ishte edhe djathi apo gjëra të tjera, por le të themi "verëra", që ka edhe një lloj mënyre konservimi të sigurt, se është në shishe, ndërsa për të tjerat mund të ketë sugjerime të ndryshme.

Pra, përveç vlerësimit për punën tuaj, thjesht sugjeroj nisur nga një fakt që kam konstatuar vetë, në njëfarë mënyre, për hotelet që kanë një lloj standardi, të paktën, të kishte një lloj mënyre që një ekspozitor për verërat shqiptare të ishte masë.

Ne kemi 60 kantina dhe patjetër ai do të thoshte se nuk i çoj dot të 60-at, por një lloj ndarjeje me zona, me tip verërash, me promovim, të paktën të atyre që ju thatë janë llojet e

rrushit tradicional, “Sheshi”, “Kallmeti”, “Mavrudi”, deri diku, “Pulsi i Bardhë” i Beratit etj. Pra, në këtë rast e kishim gati rrugën e shtruar për më vonë.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Diskutimi i projektligjit për vreshtarinë dhe verën është një lajm shumë i mirë dhe uroj që në këtë tavolinë shumë shpejt të kemi edhe ligjin për molltarinë, për ullirin dhe prodhimet e tyre, sepse të njëjtën vëmendje duhet t’u kushtojmë edhe këtyre kultivarëve, që janë pasuri kombëtare në kushtet klimaterike, që neve na ka falur Zoti.

Do të bëj disa pyetje, që u trajtuan edhe nga një pjesë e kolegëve, lidhur me peshën që ka ky sektor për të cilin ne po miratojmë një ligj të veçantë.

A është menduar që sektori i prodhimit të verës ose, duke u nisur nga të gjitha hallkat e tij, nga A-ja te Zh-ja, që nga kultivarët, tokat e të tjerat dhe deri te produkti final dhe marketingu, dalja në treg, të kthehet në një industri ushqimore? Kur themi “industri”, industria i do të gjitha, jo vetëm arkitekturën ligjore dhe aktet përkatëse nënligjore, por do strukturat përkatëse, vëmendjen dhe përkushtimin. Besoj se ia vlen.

E dyta (pothuajse është e njëjta pyetje që bëri edhe kolegu Mziu), është menduar që ky aktivitet të zhvillohet në mënyrë shkencore, bashkëkohore dhe jo primitive, si bëhet deri tani, dhe kjo e mbështetur fuqishëm nga dy institucione të rëndësishme, të edukimit dhe të formimit profesional, që është Universiteti Bujqësor dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës, që është një degë e veçantë e kimisë ushqimore në Shqipëri, e miratuar, ku bëhet jo vetëm degustimi me metoda organoleptike, por edhe shkencore. Plus kësaj, që t’i zhvillojmë këto sektorë, dhe nuk i heq asnjë presje asaj që tha kolegu Mziu, sot në mënyrë spontane mbillen kultivarët e rrushit, kultivarët e ullirit, të mollëve dhe pas 4-5 vjetëve, kur hyn në prodhim, kur shikon prodhimin, rendimentin dhe a janë përshtatur me klimën dhe me tokën, e provon fermeri dhe nuk ka pak dështime për këtë punë.

Do të sugjeroja që është një domosdoshmëri, sepse edhe në komisione të tjera ne e kemi ngritur çështjen e përgjegjësisë për formimin profesional dhe arsimin, dhe duhet të përgatisim specialistët me shkollë profesionale në fushën e bujqësisë dhe të teknologjisë të përpunimit të ushqimeve, përveç specialistëve të lartë.

Tek termat e përdorur për prodhimin e verës, pika 6 e ligjit, mos rastësisht është harruar një verë, gati antike, vera nga mjalti?

Kam edhe një shqetësim, që e përmendi edhe zoti Agron: mbrojtja e prodhimit të vendit, jo në emër të tregut të lirë, jo në emër të kërkesës dhe ofertës në treg, sepse na kalben mollët, patatet dhe prodhime të tjera, që është kapital që rëndon te qytetari shqiptar, te prodhuesi dhe te pasuria kombëtare që kemi; të mos na mbetet i stokuar prodhimi i vajit të ullirit. Unë e kam ngritur edhe herën tjetër, ndaj kërkova që të na vijë sa më shpejt edhe një ligj për ullirin dhe vajin e ullirit. Unë e kam kërkuar edhe herë tjetër. Me të drejtë u përmend këtu që para 8 vjetësh u bë një politikë lidhur me arrorët dhe prodhimin e ullinjve. Ishin deri 20 milionë rrënjë ullinj në Shqipëri, kurse tani mund të jenë 40 milionë; të mos na mbetet prodhimi i fermerëve, siç mbeti prodhimi i sezonit të para dy vjetëve.

Zonja Ministre, duhet ta mendojmë mirë këtë punë. Nuk del dot në tregun rajonal, në tregun europian një fermer në të gjitha zonat e ullirit. Duhet institucionalizuar, duhen t'u tregohen rrugët, duhet të krijohen brendet, qoftë mbi bazën e kultivarëve endemikë, tradicionalë, por edhe mbi bazën e tipologjisë gjeografike të shtrirjes së prodhimit. A është menduar për këtë punë? Neve nuk na kanë munguar ligjet, por këto produkte duhet t'i nxitim, prandaj unë do të propozoja që, para se ta kalojmë nen për nen dhe në tërësi ligjin, të bëjmë edhe dëgjesa me grupe interesi dhe me prodhuesit e verërave.

Seanca fundit e këtij komisioni për trajtimin e këtij ligji propozoj që të bëhet atje ku prodhohet, ta transferojmë zyrën që, tek e fundit, t'i bëjmë edhe një publicitet pozitiv këtij prodhimi vendas.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Beqiraj, për të gjitha sugjerimet, edhe për sugjerimin e fundit, por atje në vend kemi frikë se s'ngremë dorën dot pastaj.

Zoti Bushati.

Helidon Bushati – Meqenëse filloi me *fair play*, po e vazhdojmë kështu. Për mirëkuptimin dhe elozhet, që bëri zoti Beqiraj për politikën e ndjekur gjatë qeverisë së PD-së për vajorët dhe arrorët, i cili ka qenë një projekt shumë i vlefshëm, unë e falënderoj shumë zotin Beqiraj, pra që i dha meritat dhe vlerat që kishte ai projekt dhe shpresoj shumë që edhe projekti i vreshtarisë të jetë në lartësinë e atij projekti të bërë nga qeverisja e PD-së. Për këtë të vlerësoj shumë, zoti Beqiraj, se kjo tregon që ka një *fair play*. Këtë e pashë edhe si një lloj kritike të mbuluar ndaj Ministrisë së Bujqësisë që të ndërmarë projekte të tilla, t'i çojnë përpara projekte

të tilla, dhe kjo është gjë e mirë. Duhet t'i stimulojmë gjithmonë zërat brenda maxhorancës, të cilët stimulojnë ministrat përkatës për të arritur ato nivele që janë arritur gjatë 8-vjeçarit të PD-së.

Duke u kthyer nga ligji, që është një ligj teknik, ne jemi pro në parim, pa dyshim, sepse rregullon një fushë, e cila prek një ndër sektorët shumë të rëndësishëm, sepse jemi shumë shpesh në kontakt me produktet që do të rregullojë ky ligj dhe shpresoj t'i rregullojë.

Unë kisha një pyetje teknike, që është absolutisht jashtë njohurive të mia, por këtë e kam vetëm për njohuri teknike. Te neni 10 flitet për “varietetet që nuk i përkasin” dhe janë disa lloje: “Noa”, “Otello”, “Izabel”, “Zhak”, fatkeqësisht, keni futur edhe një “Klinton”, keni edhe “Hebermont”. Këto janë varietete, të cilat ndikojnë negativisht te varietetet shqiptare, apo çfarë? Është pyetje teknike, faktikisht, por, ngaqë s'jam i fushës më bëri përshtypje, sepse janë të specifikuar. Kjo ishte pyetja e parë.

E dyta ka të bëjë me pjesën e asaj që janë parashikuar 4 VKM, në qoftë se nuk gaboj dhe 22 urdhra ministrin, përsëri në qoftë se nuk gaboj.

Unë e kam me Albanin këtë pjesë, se nuk mund ta lë pa e ngacmuar pak. Më duken pak si shumë 22 urdhra ministri, ndër të cilët njëri më ngjall kuriozitet. Pse duhet ministri i Bujqësisë (është parashikuar te neni 7/3) të caktojë se cilët laboratorë mund të bëjnë analiza, ndërkohë që shumë mirë institucionet mund të kërkojnë certifikim të laboratorëve dhe automatikisht ata laboratorë, që kanë certifikimin e duhur, janë automatikisht të akredituar për të bërë analiza të tilla, sepse në momentin që hyn te nominalja, kur ministri cakton laboratorë në mënyrë nominale, se cili po dhe cili jo, unë mendoj se ka elemente, të cilat mund të krijojnë problematika apo dyshime të caktuara?

Gjithsesi, unë mendoj se është një numër shumë i madh urdhrash ministri dhe duhet gjetur një mënyrë që të ketë më pak urdhra ministri apo VKM, apo të jenë unifikues, sepse vetëm për vreshtarinë 22 urdhra ministri janë tepër, ndërkohë që ka edhe sektorë të tjerë. Po qe kështu, ministrin i takon të firmosë 4 urdhra në ditë, si dhe të shohë edhe zbatimin e këtyre urdhrave. Pra, mund të krijoni një ngarkesë të panevojshme ministres apo ministrin, kushdo qoftë, për mendimin tim.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Bushati!

Urdhëroni, zonja Krifca!

Frida Krifca – Atëherë, unë po i marr me radhë. Po filloj nga zoti Mziu, i cili kishte shqetësim rajonizimin. Unë jam shumë dakord me ju që ka nevojë për më shumë vlerësim dhe një studim të mirëfilltë të rajonizimit në vend, çka është, në fakt, edhe objekt i ligjit, është neni 10, pika 6, i cili kërkon që ne të kryejmë një studim, gjë që ne do ta marrim përsipër ta kryejmë, pra për zonat e kultivimit të vreshtave për verë.

Ju flisni për sanksione dhe nëse këto mund të përdoren për investime në sektor. Sipas ligjit të buxhetit, ne jemi të detyruar që sanksionet t'i derdhim në buxhetin e shtetit dhe, sigurisht, që subvencionet janë pjesë e buxhetit të shtetit dhe pastaj përdoren në funksion të ligjit të buxhetit, në ndarjen e buxhetit gjatë viteve.

Zoti Duraj, marketimi është objekt i këtij ligji, gjë që nuk ka qenë më parë. Unë jam shumë dakord me ju që ne kemi nevojë për një dorë pak më të fortë për të promovuar, për të mbrojtur disa, nuk e di sa mund të mbrojmë, sigurisht, edhe për t'u dhënë një opsion e një shans real markave shqiptare që të konkurrojnë denjësisht. Konsumatori, duke mos e pasur në menu, nuk ka se si ta zgjedhë. Nuk e bëjnë do të detyrueshme dhe ky ligj nuk e bën dot të detyrueshme, gjithsesi unë po ju zotohem këtu që, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, për sa u takon akteve që ne do të nxjerrim për agroturizmin, sepse po shikojmë që VKM-në e agroturizmit ta rishkruajmë, ta rifreskojmë, të mund të kemi disa elemente që mund t'i "diktojmë" sa të mundemi, sa hapësira e ligjit na lejon, edhe marrëveshjet ndërkombëtare për të pasur një fokus më të madhe te prodhimet lokale.

Ne po punojmë për promovimin në panairë ndërkombëtare të brendeve dhe, aktualisht, po financohet nga Ministria e Bujqësisë pjesëmarrja në aktivitete tregtare ndërkombëtare bujqësore më të mëdha, pjesëmarrja e kantineve, sipas dëshirës së tyre, në fakt, se ajo kërkon edhe një angazhim financiar personal të tyre, por, të paktën, ministria siguron ndërtimin e pavijonit, qiranë e pavijonit, pra është një mënyrë se si ne mund të arrijmë te tregjet ndërkombëtare.

Gjithsesi, mendoj se kemi shumë punë për të bërë për sa i takon promovimit brenda. Konsumatorët shqiptarë duhet të kenë një shans real për të pasur produktin, i cili, siç thamë, vjen me cilësi shumë të mirë. Pra, ky ligj rregullon marketimin, gjë që nuk ishte më parë, por nuk e bën të diktueshëm.

Zoti Beqiraj pyet nëse mund të kthehet kjo në industri. Më lejoni t'ju them që, në kundërshtim, dhe uroj që zotërinjtë e opozitës të mos ma marrin për ters, me iniciativat që kanë qenë më përpara për të mbështetur prodhimin e vajit të ullirit apo aroret, shumë mirë që kanë

qenë, por duhet të ecim paralelisht edhe me krijimin e infrastrukturës përkatëse për përpunimin e këtyre produkteve.

Ajo me të cilën përballemi ne sot është që kemi vërtet ullinj të prodhuar, kemi vaj ulliri të prodhuar në kushte informale, në kushte të prodhimit të shtëpisë, në kushte të një teknologjie jo të përshtatshme, të ruajtur në shishe plastike, në bidonë plastike nëpër hambarët e shtëpive të njerëzve.

Kemi një prodhim më të madh se sa kemi industri përpunuese dhe kapacitete paketuuese, marketuese, ruajtëse sipas standardeve që na duhen që, ose ta shesim në raftet e dyqaneve që konsumatorët ta zgjedhin, ose ta eksportojmë më pas, ndërkohë që me verën ne po bëjmë një gjë komplet tjetër, po ecim paralelisht me prodhimin dhe përpunimin, duke mbështetur shumë fort kantinat, ndërtimin e kantinave të reja. Janë buxhetuar diku te 5,6 milionë euro deri më sot në investime në kantina dhe në pajisje të reja, të cilat janë me standardet e BE-së, pikërisht për rinovimin e teknologjisë që të sjellë atë cilësi që na duhet. Pra, është shumë e rëndësishme që të ecim paralelisht me përpunimin e produkteve, por nuk mund të ecim vetëm me prodhim, pa kuptuar se çfarë do të bëhet me këtë prodhim, si do të përpunohet, si do të shitet ky prodhim me një standard që e kërkon tregu.

Pra, ne po e kthejmë këtë sektor në një industri, duke financuar seriozisht me 5.6 milionë euro, deri më sot, ndërkohë që e kemi në plan mbështetjen edhe më tej të sektorit. Bashkëpunimi me universitetin është pjesë e këtij ligji. Në Këshillin Kombëtar të Vitikulturës ka një përfaqësi të universitetit Bujqësor të Tiranës.

Për sa i takon pyetjes suaj, nëse është vera e mjaltit pjesë e këtij ligji, thekson se ligji rregullon vetëm prodhimin e vitikulturës.

Zoti Bushati, çuditërisht, ju jeni shumë i mirë me mua sot. Bëtë vetëm vërejtje për Albanin. Unë e pranoj këtë me kënaqësi. Pjesa e varieteteve që përmendët, edhe ai me emrin e Klintonit, nuk janë pjesë e “Vitis vinifera” dhe trajtohen veçmas, pra është një nomenklaturë ndërkombëtare më vete dhe prandaj trajtohet veçmas.

Jam dakord me ju. Edhe unë do ta doja barrën time administrative të gjërave që firmos më të ulët, kështu që Albani duhet ta shohë këtë çështje.

Shumë faleminderit që e sillni në vëmendje!

Arben Pëllumbi – Zoti Beqiraj, për shtesë sqarimi.

Ismet Beqiraj – Zonja Ministre,

Sinqerisht, me këtë përgjigje, mua, jo e jo që nuk më kënaqe, kur trajtove vajin e ullirit, por edhe ata mijëra e mijëra fermerë që kanë mbjellë ullinj. Edhe pse jemi në krizë, uroj që prodhimi i sivjetmë t'ia kalojë të parvjetshmit dhe, të themi ne që vaji i ullirit do të rrijë i stokuar se nuk ka industri të përpunimit, rafinimit dhe të marketingut...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj - Të lutem, merre fjalën pas meje.

Jo, të lutem!

Të lutem, ulliri nuk mbillet sot, se nuk është si ferra, që të japë prodhimin nesër. Ulliri, maksimalisht do 5 deri në 6 vjet që të rritet dhe të japë prodhimin. Mbjelljet e agrumeve që janë masivizuar në Shqipëri, madje edhe në zona ku më parë nuk bëheshin agrumet apo edhe ullinjët, kanë ndodhur për shkak të efekteve klimaterike, janë mbjellë, por ne nuk jemi të përgatitur.

Zonja Ministre, kur jepen grante nga projekte të ndryshme për fabrikat për prodhimin e vajit të ullirit, njëri nga kushtet për fermerin që do të marrë 100, 200, 300 apo 500 euro grant, është që të bëjë edhe linjën e ambalazhimit, edhe kontrollin cilësor, që të jetë në përputhje me standardet e pranuar të tregut europian dhe rajonal. Nuk mund ta lëmë këtë sektor jetik pa mbështetje, sepse unë po e ngre zërin sot, në mënyrë që të jemi të gjithë të qetë, që kur të fillojë sezoni, fermerët të mos jenë më në thonjtë e grumbulluesve, dhe që vaji i ullirit të mos ketë çmimin që ka sot, kur koston e ka shumë të lartë, sepse e ka çmimin më të ulët se vajrat e tjerë që ne përdorim.

Arben Pëllumbi - Zoti Beqiraj, ju lutem, përtej shqetësimit që keni, po diskutojmë për verën sot, jo për vajin e ullirit. Nëse dëshironi, e thërrasim ministren në një seancë të veçantë, për të diskutuar për vajin e ullirit.

Ju lutem, mos na e shpërqendro vëmendjen nga çështja që kemi sot.

Zoti Mziu do të bëjë një ndërhyrje dhe pastaj e ka fjalën zoti Likaj.

Xhelal Mziu – Zonja Ministre, po bëj një ndërhyrje të vogël.

Në fakt, marr shkas, ishte dhe koincidencë, se para në jave komunikova me disa kolegë të Universitetit Bujqësor, që janë pjesë e degës së hortikulturës, të cilët më shprehën shqetësimin e tyre që në vitin e parë, për vitin akademik 2021-2022 ishin vetëm 7 studentë. Në lidhje me këtë gjë, unë kërkoj ndërhyrjen e autoritetit tuaj për dy gjëra, të cilave duhet me patjetër t'u jepet zgjidhje.

Së pari, nuk e kuptoj pse duhet të jetë nota mesatare përjashtuese, kur një student, po them nga zonat e thella, për shkak të kushteve, jo vetëm që nuk ka arritur që të kapë mesataren, por e ka të nevojshme që të shkojë në atë degë. Për këtë ka një zgjidhje, që është ulja e notës mesatare për këto degë që janë të rëndësishme si hortikultura, vitikultura, agronomia, zooteknia dhe veterinaria.

Së dyti, siç bëjnë edhe universitetet e tjera analoge jashtë Shqipërisë, për degë të rëndësishme si këto, universiteteve apo fakulteteve të caktuara, sidomos kur ato janë shtetërore, u jepen stimulime. Bie fjala, vetë Ministria e Bujqësisë, kuptohet nëpërmjet qeverisë, mund të akreditojë në këto universitete një numër të caktuar bursash. Pra, një student merr bursë dhe mund të shkojë të riskojë, nuk shkon te një degë tjetër, por tek ajo, sepse përfiton bursë. Pra, me pak fjalë, ne po diskutojmë për vreshtarinë dhe në fakt, studentë nuk ka, dega po shkon drejt mbylljes. Pra, nëse ne nuk prodhojmë kontinegjente si mund ta stimulojmë, si mund ta mbajmë të hapur në vitet që vijnë këtë degë? Pra, këto janë dy ndërhyrje që ju duhet t'i bëni, sepse ka referenca edhe në vende të tjera të rajonit apo edhe të Europës.

Së dyti, ka edhe një mundësi tjetër, shkollat profesionale. Po të shikosh sot, shkollat profesionale janë kthyer vetëm për kuzhina dhe servis. Në fakt, unë mendoj se nuk duhet të jenë vetëm këto drejtime, sepse dikush që shkon në arsimin profesional të mesëm e bën për shkak të moshës, dhe për shkak se futet më shpejt në tregun e punës. Mundet që ju me influencën tuaj të hapni degë për këtë sektor shumë të rëndësishëm, të bujqësisë, të hortikulturës, të vitikulturës, të agronomisë apo edhe sektorë të tjerë.

Këto janë shqetësime që unë i shikoj si emergjente, sepse në aspektin jo afatgjatë, por afatmesëm ne do të ngelemi pa specialistë përkatës.

Një gjë tjetër të fundit, në lidhje me rishikimin e akcizës. U ngrit si shqetësim dhe mendoj se akciza mund të shikohet qoftë për importin e produkteve tona për t'i stimuluar, qoftë për eksportin e tyre apo edhe për importin e verërave, të cilat konkurrojnë tregun, që nuk kanë një cilësi, por mund të manovrohet me rritjen e akcizës ose të gjendet një instrument tjetër.

Këto janë shqetësimet e mia, por sidomos shqetësimi i parë është vërtet real dhe jam i sigurt që do të ndodhemi në një situatë vakumi të burimeve njerëzore në këtë drejtim.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Mziu!

Në fakt, ne edhe në një aktivitet të përbashkët që patëm me ministren përfituam nga rasti për t'i bërë thirrje rinisë që të regjistrohet në universitete. Unë jam dakord me shqetësimin tuaj,

ndoshta duhet të gjejmë mundësinë që ne të rrisim mbështetjen buxhetore për bursa në këto dege, por nuk jam dakord për uljen e notës mesatare. Edhe në ato universitete duhet të shkojnë njerëz që kanë dëshirë të mësojnë dhe kanë kapacitete ta përfundojnë atë shkollë ashtu siç duhet, që të mos na ndodhë pastaj që të na shartojë vreshtin me kumbullën dhe na del mollë. Kështu, të mos e ulim cilësinë, por që ta mbështesim me bursa, jam plotësisht dakord me sugjerimin tuaj, që të gjejmë mundësinë në një degë prioritete siç është bujqësia, do ta shikojmë edhe me Ministrinë e Arsimit, që ta mbështesim me bursa më të shumta dhe me vlerë më të madhe, që t'i nxisim të rinjtë të shkojnë në atë universitet, por ndërkohë për notën mesatare mendoj se nuk duhet ulur.

Fjalën e ka zoti Lika.

Ramadan Likaj - Faleminderit, kryetar!

faleminderit, ministre, për ekspozenë që i bëtë këtij ligji dhe të gjithë trupës suaj të Ministrisë së Bujqësisë!

Sigurisht që ndihem i privilegjuar t'i them disa fjalë për këtë projektligj në diskutim.

Falënderoj të gjithë kolegët për ekspozenë që i bënë këtij ligji! Sigurisht, ndihem mirë që ky ligj të mos ketë ngutjen e duhur, por të ketë kohën e duhur dhe të diskutohet sa më gjerë, pse jo edhe me grupet e interesit, të dilet në terren dhe të shikohen gjërat më konkretisht, të merren parasysh të gjitha problemet që kanë realisht prodhuesit shqiptarë në këtë fushë.

Gjithashtu, dua t'u shpreh një falënderim të jashtëzakonshëm të gjitha kantinave, njerëzve që kanë marrë përsipër një fushë kaq të vështirë në Shqipëri. Unë me të vërtetë mund t'i quaj heronj. Sigurisht, për shumë vjet nuk është bërë aq sa duet në këtë drejtim. Mendoj se sot ka ardhur koha që të gjithë së bashku, pa asnjë lloj paragjykimi, siç e dha në krye të herës edhe relatori, të kemi durimin e duhur që të marrim sa më shumë informacion dhe pastaj të bëjmë dhe rregullimet e duhura për këtë ligj.

Për sa i përket prodhimit shqiptar, të gjitha kantinat, pak a shumë, kam pasur mundësi t'i kontaktoj dhe të më kontaktojnë, duke më shprehur probleme nga më të ndryshmet. Një ndër specifikat që unë mendoj se tashmë prodhuesit shqiptarë kanë marrë edhe orientimin e duhur, në bazë të zonave dhe vendeve të ndryshme që ka Shqipëria, është që të orientohemi se cilat janë varietetet e rrushit në bazë të zonave. Mendoj që kjo është pika më e rëndësishme.

Unë mund të them që prej disa vjetësh ose vitet e para që ka filluar kjo veprimtari në Shqipëri nuk kemi pasur specialistët e duhur. Sigurisht, edhe mbështetja nga organet kompetente nuk ka qenë dhe duhet të jemi të sinqertë për këtë. Të vetmen gjë që kemi pasur ka qenë nisma

ose vullneti, dëshira e madhe për të bërë biznes në këtë fushë në Shqipëri. Pastaj, duke ecur vitet, duke orientuar veten, duke gjetur edhe njerëzit e duhur, duke afruar edhe specialistë të mirëfilltë, pse jo duke marrë edhe asistencë ndërkombëtare, unë mënoj që sot mbas një sakrifice të gjatë, shumë të gjatë madje, mund ta quaj unë, kemi marrë orientimet e duhura. Unë flas për zonën nga vij, zona e Malësisë së Madhe, e cila është një zonë potenciale, mund ta quaja për prodhimin e rrushit, por jo për të gjitha varietetet, për të qenë i sigurtë. Kemi pasur edhe defekte gjatë këtyre viteve, kemi pasur edhe humbje jo të lehta, se në disa zona disa varietete janë të papranueshme dhe kjo ka krijuar një ngërç jo të vogël. Malësia e Madhe ose zona e Koplikut, zaret e Koplikut quhet në tërësinë e saj, është një zonë e mrekullueshme për sa i përket kultivimit të rrushit. Në bazë të studimeve, në bazë të statistikave, në bazë të analizave që kemi bërë ndërkombëtarisht, deri në këto momente kemi përcaktuar edhe varietetet që mund të prodhohen në këto zona.

Sigurisht, edhe kolegu Duka e përmendi shumë mirë, sot ne nuk prodhojmë rrush 200 kuintalë e më shumë, por ndoshta për të krijuar një verë të mirë, maksimalja, prej 1 hektari, ne mund të marrim 8 ose 9 tonë rrush, se 10 tonë i kap kurrë, në qoftë se duam të prodhojmë një verë cilësore. Këto janë statistika të sakta. Sigurisht, u futëm në këtë proces para disa vitesh, falë bashkëpunimit edhe me ekspertë të mirëfilltë ndërkombëtarë, të cilët tashmë i kemi të pranishëm edhe nëpër kantinat tona, se duhet të jemi të sigurtë në ato që themi, për të thënë edhe se ku qëndron defekti.

Për shembull, mund të them se në kantinën që unë kam drejtuar për shumë vjet, afrova një ekip të specializuar nga vendet e Bashkimit Europian, me dëshirën e çdo tregtari, çdo investitori që kërkon të gjejë specialistët e duhur, në vendin e tij (ndoshta po ju mërzis, kolegë, por mendoj se është krejtësisht normale ta bëjmë këtë ekspozitë për të dhënë njohuri), për të ndryshuar qasjen dhe për të rritur sa më shumë cilësinë e verës. Pse? Sepse nuk kishim nivelin e duhur. Çfarë ndodhi, miqtë e mi? Ata erdhën me shumë dëshirë, vizituan kantinën para 7 vjetësh dhe përgjigjja e tyre ishte: “Do të marrim analiza për të gjitha produktet që ke në kantinë. Besojmë se për 3 muaj do të analizojmë të gjitha produktet që ke gjendje, pas 3 muajsh do të paraqesim raportin tonë”.

Sigurisht që ne pranuan dhe mbas 3 muajsh erdhi një raport dhe kur unë me të gjithë specialistët e kantinës tim kemi parë analizimin e të gjitha produkteve, për të cilat mendonim se ishin në nivel shumë të lartë, fatkeqësisht po ju them, u tmerruam. Pastaj ndodhi ajo që ndodhi.

Në bashkëpunim edhe me universitetin, se aty ka specialistë shumë të mirë, ka enologë të mirëfilltë, u futëm në një diskutim të gjerë dhe vendosëm që realisht këtë produkt ta largonim nga kantina. E bëmë me një dhimbje të jashtëzakonshme, se ishte një vlerë e konsiderueshme, por specialistët e huaj nuk e merrnin përsipër një kantinë në qoftë ajo nuk pastrohej nga një produkt i kontaminuar. Pra, deri në këtë pikë kishte shkuar situata, ndërkohë që ne mendonim se prodhonim verëra të mira. Sigurisht, kjo gjë u arrit dhe sot kantina ka një qasje tjetër.

Unë bëra një ekspozitë për atë kantinë që e kam drejtuar për disa vjet, por mendoj se të gjithë kolegët e mi në Shqipëri kanë pasur fenomene të tilla në kantinat e tyre. Pse? Nga mospërvoja, mosqasja e duhur, e cila na ka çuar në humbje të jashtëzakonshme ekonomike.

Unë mendoj se sot të gjithë prodhuesit shqiptarë kanë krijuar ekipe të mirëkualifikuara, bëjnë trajnime ndërkombëtarisht dhe kanë krijuar stafe që janë të gatshëm të prodhojnë verëra cilësore, edhe në Shqipëri. Mendoj që kolegët këtu, në mënyrë të veçantë edhe hartuesit e këtij projektligji, të kenë durimin e duhur, që ky projektligj të mos e marrë miratimin shpejt e shpejt. Pse e them këtë? Jo thjesht se flas për interesa të një grupimi të caktuar, në mënyrë absolute jo, pasi kërkoj që kjo kohë të jetë kohë reflektimi për të gjithë prodhuesit shqiptarë në Shqipëri. E para.

E dyta. Kërkoj nga Ministria e Bujqësisë të krijohet një departament i veçantë vetëm për prodhimin e verërave, sepse mendoj që i vlen jashtëzakonisht këtij vendi.

Për sa i përket importit të produkteve, e përmendi edhe kryetari, ne nuk jemi një vend që mund të ndalojmë importet, se jemi drejt Bashkimit Europian, por, absolutisht, me politika, me analiza mund të krijojmë barriera çdo importi që futet në Shqipëri.

Zonja Ministre, unë mora shkas nga ju, kur thatë që çdo produkt importi të futet me fletanalizë. Absolutisht po, nuk jam kundër kësaj gjëje, por nëse krijohet një bord i mirëfilltë mbi bazën e fletanalizës të çdo produkti që futet në territorin e Shqipërisë (për sa u përket verërave gjithmonë), të merret fletanaliza, të merren produktet të rianalizohen nëpër laboratorë të pavarur, të specializuar, jo që janë të përcaktuar nga qeveria ose nga dikush tjetër, por laboratorë të pavarur, ju siguroj që fletanaliza e atij produkti që futet në Shqipëri, nuk do të rezultojë e njëjtë me produktin që ka shishja brenda. Për këtë të jeni të sigurt.

Si prodhues mendoj se sot në Shqipëri nuk duhet të futet kurrë një verë që kushton 2,5 euro dhe të thuash që ka cilësi të mirë. Pse e them këtë? Sepse kjo është shumë e thjeshtë, se ne si prodhues shqiptarë kemi një kosto sot, duke filluar prej lëndës së parë, prodhimin të lëndës së

parë, vështirësinë që ka, deri sa shkon te kantina në të gjitha procedurat, ka kosto. Kështu që, sinqerisht po jua them, nuk e di se nga kush prodhohet kjo verë që vjen në Shqipëri. Politikat zhvilluese të Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë të Ministrisë së Bujqësisë, duhet të kenë vëmendje të veçantë për sa i përket prodhuesve shqiptarë. Unë i them këto, se kam optimizmin e duhur për këtë punë.

Falënderoj të gjithë kolegët në Shqipëri për punën që kanë bërë deri tani!

Unë besoj se qasja e qeverisë është gjëja më e rëndësishme për të mbrojtur prodhuesit shqiptarë. Dua të përmend disa shembuj nga shtete të tjera, se nuk them që të përdorim politikat e Bashkimit European, pasi e kemi të pamundur sot, por hap pas hapi mbështetja duhet të vijë nga shtetet fqinjë. Po përmend Malin e Zi. Nuk e di sa informacion keni, sesi operon Mali i Zi në këtë fushë, por sikur të merrnim modulën e tyre dhe ta fusnim në Shqipëri, unë besoj se prodhuesit shqiptarë do të kenë një qasje tjetër, një ecuri dhe zhvillimi do të jetë shumë më i shpejtë. Po ashtu, po të shikojmë Maqedoninë e Veriut, pse jo edhe Kosovën, pa shkuar te shtetet e Bashkimit European.

Duke qenë i apasionuar pas kësaj fushe, fati i mirë më ka çuar të lëviz në shume vende të botës, ku kam kuptuar shumë nga të gjithë prodhuesit në Europë, sepse është për t'i marrë shembull si në Francë, si në Itali, si në Spanjë pse jo dhe në zona të ndryshme të Gjermanisë, ku ka varietete që ju i njihni shumë mirë. Vërtet Gjermania është një vend shumë i ftohtë, por në zona të ndryshme prodhohen verëra të shkëlqyera. Pa shkuar në zona të Shteteve të Bashkuara, në Kaliforni dhe vende të tjera.

Pra, dua të them se Shqipëria ka një potencial të jashtëzakonshëm për prodhimin e verërave, se ka një tokë të mrekullueshme. Atëherë, shtrohet çështja nëse duam realisht t'i japim prioritet kësaj fushe që u përket të gjithëve. Unë mund të them se zona ku unë kultivoj (dhe të gjitha zonat e Shqipërisë në përgjithësi apo të gjitha zonat e Mesdheut), ka diell rreth 288 ditë të vitit, që do të thotë atje se bëhet një prodhimin me një cilësi të shkëlqyer. Sot ne po ndërrojmë për ditë metodikat e kultivimit dhe të ngritjes së një vreshti, se deri para disa vitesh kemi ecur me metodikën, që kemi pasur historikisht. Çfarë ndodh? Ne si kantinë, në bazë të zonave ku kemi pasur vreshtat tanë, po detyrohemi t'i heqim këto vreshta. Pse? Sepse ato varietete të mbjella atje nuk i përkin asaj zone.

Këto janë gjëra të dhimbshme, por sigurisht nëse duam të shkojmë drejt një progresi, që të prodhojmë verëra cilësore, duhet t'i pranojmë edhe këto dhimbje. Sigurisht, në zonat tona

prioritet është Kallmeti. Ai është një produktet autokton, është një produkt, të cilin edhe ju, edhe ne, edhe të gjithë së bashku, në qoftë se arrijmë ta çojmë në nivelin e duhur, mund ta çojmë për eksport këtë produkt. Ne nuk mund të bëjmë eksport me varietet europiane, të jeni të bindur për këtë. E di këtë gjë nga dëshira e madhe që kam pasur edhe kam, po kjo gjë është e pa mundur.

Unë mendoj se kantina që kam drejtuar, edhe nga ana teknologjike ka një nivel teknologjik të lartë, bashkëkohor mund ta quaj.

Sot i gjithë ekipi ndërkombëtar po monitoron, po jep asistencë të përditshme në atë kantinë dhe kryesorja është që ata kanë përcaktuar zonën dhe çfarë varieteti duhet në secilën prej tyre. Ne po e bëjmë më së miri këtë gjë dhe jam i bindur se nëse ne do të ecim me këto ritme, do të ndodhë në të gjithë Shqipërinë.

Berati është një zonë e shkëlqyer, por edhe atje janë të përcaktuara varietetet.

Gjithashtu, duhet të bëhet një ndërthurje për të gjithë prodhuesit shqiptarë, që verërat tona duhet të jenë të pranishme në çdo restorant të vendit, pse jo edhe në hotele. Siç e tha kolegu, është për të ardhur keq që në të gjithë bregdetin tonë nuk ka verë shqiptare, në një kohë që ka ndryshuar edhe qasja e të gjithë turistëve që vijnë në Shqipëri, sepse kur ata pyesin nëse ka është prodhime vendase, të gjithë kamarierët apo menaxherët e restoranteve shprehen se Shqipëria nuk ka verë të mirë. Kjo është për të ardhur keq!

Nga ana juaj, pse jo edhe nga ne, duhet të jepet një ndihmë e jashtëzakonshme për t'u bërë përmirësimet e duhura, të pranojmë realitetin nëse duam të ecim përpara.

Për ta mbyllur fjalën time sot, nuk dua të futem në gjëra teknike për sa kohë që janë grupet e interesit, do të ketë edhe dëgjesa me drejtuesit e universiteteve, pasi kanë një pjesë shumë të rëndësishme në këtë proces, unë jam dakord absolutisht në parim, e përkrah dhe e mbështes çdo nismë të tillë, por çdo gjë që do të arrihet, duhet t'i shërbejë të ardhmes dhe ekonomisë së këtij vendi.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Zoti Likaj, ju falënderojmë për ekspozenë dhe e çmojmë ndihmën tuaj dhe të zotit Duka për përmirësimet e nevojshme që mund t'i bëjmë këtij projektligji!

Zonja Ministre, në kuadër të diskutimeve në bashkëpunim me OSBE-në kemi vendosur të bëjmë një seancë të këtij komisioni pranë një prodhuesi verërash në Veri, që edhe kolegët të kenë mundësi të informohen më mirë për vreshtin, fermentimin, paketimin, mirëmbajtjen dhe konservimin, pasi besojmë se të gjithë jemi të qartë që ka një potencial shumë të madh rritës,

çoftë në konsumin lokal, edhe në eksport. Ne të gjithë e mbështesim këtë projektligj dhe duhet ta çojmë në standardet që t'i shërbejë realisht të ardhmes së këtij produkti dhe rritjes së mirëqenies së atyre që merren me këtë fushë.

Jam dakord që duhet të promovojmë, por krahas promovimit, ne të parët duhet të fiksojmë mirë në kokë një postulat: të punojmë *made in Albania* për çfarëdolloj produkti, por, që të mund të punojmë për këtë gjë, ne të parët duhet të rrisim besimin te produkti ynë. Gjithçka fillon duke bërë një ligj të mirë, duke dhënë mbështetjen e duhur, duke pasur vizionin e duhur, strategjinë e duhur, që të rritet edhe besimi te produkti lokal.

Duke marr shkak nga ajo që tha zoti Dura, edhe unë kam pasur një rast të tillë shumë vjet më parë. Kishim vizitorë disa të huaj dhe unë me shumë kënaqësi i ofrova një nga verërat e zonës së Tiranës. Duke pritur me pasion të dëgjoja çfarë do të thoshte, ai u shpreh: Uroj ta bëjmë shpejt dollinë, se më pas bëhet uthull!

Kjo situatë tashmë ka kaluar, sepse prodhuesit tanë janë rritur, por ndërsa faza nga zero në dhjetë mund të lëvizte shpejt, për të shkuar tashmë nga dhjeta në njëmbëdhjetë duhet shumë punë dhe njohuri, si studimi i terreneve. Ne të gjithë jemi në dijeni se janë mbjellë vreshta edhe në terrene që nuk janë të përshtatshme, ka pasur dështime, si në terren, edhe në llojin e rrushit të mbjellë. Besoj se i gjithë bashkëpunimi në këtë fushë, duke nisur nga përmirësimet dhe ndërhyrjet që ju mendoni të bëni në këtë ligj, t'i shërbejnë këtij sektori, i cili realisht ka potencial të madh dhe besoj se është nga ata sektorë kur produkti e plotëson të gjithë ciklin e vetë, e merr të gjithë të ardhurën brenda vendit.

Në bujqësi ne flasim të rrisim industrializimin për shumë produkte, në vreshtari arrijmë ta çojmë deri në fund, pra ta marrim të gjithë ciklin e prodhimit brenda vendit dhe të rrisim të ardhurat për njerëzit, duke pasur parasysh edhe filozofinë që bujqësia të mos jetë një sektor mbijetese, por një sektor që prodhon biznes dhe mirëqenie për ata që merren me të.

Ka diçka tjetër nga kolegët?

Ne do të bëjmë disa seanca.

Sot vetëm e çelëm këtë projektligj.

Do të zhvillojmë disa seanca dëgjimore, ku do të ftojme të gjithë aktorët e interesuar për të marrë pjesë. Kemi një konsensus të plotë nga propozuesit dhe nga zonja ministre, që ne të diskutojmë për më të mirën e mundshme.

Besoj se në fund do të nxjerrim një produkt që, nuk po them se do të jetë shterues, sepse e mira nuk ka fund, por besoj se do të jetë një produkt i mirë, sepse nuk mungon vullneti i propozuesit, që ky projektligj të jetë realisht në mbështetje të këtij sektori.

Keni diçka, zoti Bushati?

Helidon Bushati - Pak a shumë mund të jetë përsëritje e problematikave që dolën, por meqenëse ju po punoni për VKM-në për agroturizmin, që e keni vetë parasysh, mendoj se Ministria e Turizmit, me urdhrer ministri për standardet e hoteleve, tipologjive mund të vendosë që 1/3-a e listës së verërave të jetë shqiptare. Ju mund ta ngrini si shqetësim, edhe ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ndoshta nuk hyn te VKM-ja për agroturizmin, sepse është tipologji tjetër komerciale, por në hotelet me 3, 4 apo 5 yje, 1/3-ta e listës së verërave, sado e gjatë, të jetë domosdoshmërisht me verëra shqiptare.

E dyta, pas 30 vjetëve demokraci shumë shqiptarë sipërmarrës kanë hapur restorante pothuajse në të gjitha vendet e botës. Kur ne shkojmë jashtë vendit në një restorant tipik, si: tajlandez, kubanez, ata kanë një listë verërash të vendit ku ushtrojnë aktivitetin, por kanë edhe verërat e tyre autoktone.

Ju përmendët një shifër prej 5 milionë eurosh të dhënë nga AZHBR-ja për kantinat, por a mund të bëhet një projekt apo të jepet një fond nga ministria pikërisht për sensibilizimin që në restorantet e shqiptarëve të shiten verëra etnike? Pa dyshim, nuk mund t'ua imponosh, sepse bëhet fjalë për sipërmarrës shqiptarë që jetojnë jashtë, por të bëhet një sensibilizim, që në listat e tyre të kenë edhe 2-3 verëra shqiptare. Këto janë sugjerimet e mia.

Frida Krifca – Për sa i përket VKM-së për agroturizmin, edhe në kontratat e AZHBR-së me subjektet që marrin financim nga buxheti i shtetit për ndërtimin e bujtinave apo për shërbime të ndryshme, ne kemi kërkuar që produktet të jenë patjetër të vendit. Ata mund të kenë produkte të tjera, por duhet të kenë produkte vendi. Në objektin e kontrollit të këtyre investimeve, që kryhen të paktën 2 herë gjatë implementimit të investimit në 5 vjet, ne kontrollojmë nëse ata i kanë produktet, pra nëse e kanë verën shqiptare.

Nëse shkoni në kantinën Enol, ata e prodhojnë vetë verën dhe ndoshta nuk është shembulli i duhur, por nëse shkoni në Gjepalaj të Shijakut, objekt i investuar nga buxheti i shtetit, dhe nuk e gjeni verë shqiptare, ne kemi penalitete, që arrijnë deri në konfiskimin dhe kthimin e investimit.

Për sa i përket agroturizmit, unë kam qenë një iniciatore e kësaj ideje, sepse realisht kemi nevojë ta shtojmë produktin shqiptar në menytë e këtyre subjekteve. Tani duhet ta shtrijmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në atë kohë kemi mbështetur objektet e agroturizmit, jo hotelet, por ky diskutim duhet bërë me ministren e Turizmit dhe Mjedisit, dhe mund ta iniciojë kryetari, që të gjejmë hapësirat e duhura rregullative për këtë gjë. Jam shumë dakord me ju.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Ministre, për të gjitha shpjegimet tuaja!

Mbledhja mbyllet.

Nesër kemi mbledhje në orën 10:00.

MBYLLET MBLEDHJA